



AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE QERSHOR 2024

TË ARDHURAT E 6-MUJORIT, DOGANAT ARKËTOJNË 110 MILIARDË LEKË & 0,2%

MË SHUMË SE PLANI

Të ardhurat doganore (të ardhurat nga TVSH në import, akciza, taksa doganore dhe renta minerare) gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024 u realizuan në vlerën **110 miliardë lekë**, ose rreth **7 miliardë lekë** më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, si dhe **0,2%** më shumë se plani i të ardhurave doganore për 6-mujorin e vitit 2024. Vlen të theksohet se tejkalimi i planit në gjysmën e parë të vitit është arritur pavarësisht efektit të madh të humbjes që vijon të shkaktojë rënia e kursit të këmbimit, që për këtë hark kohor përlogarit në **10,8 miliardë lekë**. Po ashtu edhe të ardhurat nga akciza në 6-mujorin e parë kanë arritur në nivelet më të mira historike me **+13,800 ton karburant**, **+95 ton cigare**, **+101 ton kafe** dhe **+2900 ton birrë**.




TAKIMI I TRETË BRENDA VITIT - DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE SHQIPTARE ME HOMOLOGUN ITALIAN NË ROMË

Në vijim të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Administratave Doganore të Shqipërisë, Italisë dhe Guardia di Finanza, firmosur në Tiranë më **4 prill 2024**, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me drejtorin e ADM, Roberto Alesse. Në këtë takim, i tretin midis tyre brenda vitit, të dy Drejtorët e Përgjithshëm ritheksuan rëndësinë e intensifikimit të marrëdhënieve midis dy administratave doganore, në mënyrë të veçantë asistencën teknike në fushën e akcizës!



ANKETA E INDEKSIT TË BIZNESIT TË DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË VLERËSON NË NIVELIN MË TË LARTË MARRËDHËNIET ME DOGANAT

Dhoma Amerikane e Tregtisë publikoi Anketën e Indeksit të Biznesit ku marrëdhëniet me Administratën Doganore janë vlerësuar në nivelet më të larta krahasuar me institucionet e tjera. Sipas sondazhit me anëtarët e AmCham, marrëdhëniet me Doganat janë përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme tre vitet e fundit, duke arritur në vitin 2023 nivelin më të lartë, rreth **64,4%**, ndërkohë që indeksi mesatar shënoi rreth **47,6%**. Presidenti i AmCham, Grant Van Cleve, e vlerësoi si shumë pozitiv bashkëpunimin me Administratën Doganore në funksion të përmirësimit të klimës për biznes në Shqipëri.



VIZITË STUDIMORE NË INSTITUTIN POLIGRAFIK ZECCA DELLO STATO

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Administratave Doganore të Shqipërisë, Italisë dhe Guardia di Finanza, firmosur në Tiranë më **4 prill 2024** dhe në vijim të zbatimit të planit të veprimit të ndërsjelltë, një delegacion i nivelit të lartë i Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë zhvilloi një vizitë studimore tek Instituti Poligrafik "Zecca dello Stato" në Romë. Arsyja e kësaj vizite është vendosja e urave të bashkëpunimit ndërinstucional me këtë Institut, pasi duke filluar nga data **1 janar 2025**, pulla fiskale si letër me vlerë dhe monopol shtetëror do të prodhohet dhe do të shpërndahet nga një subjekt i autorizuar nga Këshilli i Ministrave, një eksperiencë e ngjashme me atë të Italisë.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE NË KËSHILLIN E SELEC

Drejtorja e Përgjithme e Doganave mori pjesë në sesionin e 24-të të Këshillit të SELEC (Southeast European Laë Enforcement Center) që u mbajt më **30 maj 2024** në selinë e SELEC në Bukuresht/Rumani. Në këtë sesion, krahas çështjeve buxhetore, një temë e rëndësishme ishte kërkesa e Byrosë Kombëtare të Hetimit të Shqipërisë për t'u bërë Partner Operacional i SELEC, kërkesë e cila u miratua nga Këshilli. Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SELEC, i përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë të Shteteve Anëtare të SELEC.



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI "MBI KRIJIMIN E OBSERVATORIT TË LOGJISTIKËS DETARE DHE ZINXHIRËVE TË FURNIZIMIT"

Nën kujdesin e veçantë të zv/kryeminstres dhe ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Belinda Balluku u nënshkrua në Durrës memorandumit "Mbi krijimin e Observorit të Logjistikës Detare dhe Zinxhirëve të Furnizimit". Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Memorandumi u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Genti Gazheli. Observatori do të shërbejë si një platformë ndërinstucionale digjitale për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave mbi logjistikën detare dhe zinxhirët e furnizimit në Shqipëri. Sipas memorandumit, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave anagazhohet të furnizojë me të dhëna statistikore mbi vëllimet tregtare të mallrave të importuara/eksportuara/transitit përmes porteve shqiptare, si dhe të ndihmojë në identifikimin e vendeve të originës dhe destinacionit, vlerës dhe të dhëna të tjera publike dhe të dobishme për qëllimet studimore të observorit.



AUTORITETET DOGANORE NË BASHKËPUNIM ME POLICINË E SHTETIT SEKUESTROJNË 35 755 EURO TË PADEKLARUARA

Në datën **9 qershor** është finalizuar operacioni i koduar "Next", për goditjen e tentativës për të futur në Shqipëri një sasi prej **35 755 eurosh**, pa deklaruar të cilat janë sekuestruar dhe materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme, për veprën "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë". Duke marrë shkas nga rastet e fundit dhe në funksion të ndërgjegjësimit të udhëtarëve, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave njofton se bazuar në ndryshimet e ligjit nr.9917, datë 19.5.2008, i ndryshuar, të gjithë personat të cilët hyjnë në/ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shumata **10 000 euro** ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse. Procedurat e deklarimit kryhen pranë zyrave të Administratës Doganore, në Pikën e Kalimit Kufitar, hyrje apo dalje.



DOGANA DIGJITALE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit Qershor 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **134 shërbime online**.

